

GJYKATA E AELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM



ÇFARË PËRFAQËSON?

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është gjykata e vetme në nivel apeli, e cila vijon rregullisht ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore e administrative të të gjitha gjykatave të apelit.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm fillon funksionimin më datë 01.02.2023.

Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, ndërpresin veprimtarinë në datë 31.01.2023.

CILAT JANË KOMPETENCAT?

- Kompetencat e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm shtrihen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Gjykatat e Apelit Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë, pushojnë së funksionuari pas datës 1 Shkurt 2023 dhe kompetencat tokësore të tyre përthithen nga Gjykata e Apelit Tiranë, me emërtimin e ri të ndryshuar në: “Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm”.
- Zyrat e Shërbimit janë pjesë e shërbimeve administrative të ofruara nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të cilat ngrihen dhe funksionojnë pranë godinave ish Gjykatave të Apeleve Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë dhe Shkodër me qëllim ofrimin e shërbimeve administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor.

CILAT JANË ORGANET E ADMINISTRIMIT GJYQËSOR?

- Këshilli i Gjykatës
- Kryetar/Zëvendëskryetar
- Kancelar

TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE NË GJYKATËN E AELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

ÇËSHTJET GJYQËSORE QË TRANSFEROHEN NË GJYKATËN E AELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatat e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë deri në datën 31.01.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm rindahen me short elektronik, në përputhje me kriteret e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

ÇËSHTJET GJYQËSORE QË NUK RINDAHEN ME SHORT

Çështjet gjyqësore të transferuara, për të cilat ka filluar apo është planifikuar shqyrtimi gjyqësor në Gjykatat e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, nuk i nënshtrohen rindarjes me short.

Këto çështje do të vijojnë të shqyrtohen nga të njëjtët gjyqtarë.

Planifikimi i datave për gjykimin e çështjeve gjyqësore për të cilat ka filluar apo është planifikuar shqyrtimi gjyqësor, në Gjykatat e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, do të bëhet deri në 31.12.2022. Ky rregull nuk gjen zbatim për çështjet urgjente sipas ligjit.

Adresa e Gjykatës:

Bulevardi “Zhan D’Ark”
(Godina aktuale e Gjykatës së Apelit Tiranë)

Kontakte:

- ✉ sherbime@gjykata.gov.al
- ☎ +355 67 73 74 414
- 📞 +355 67 73 74 414

ÇFARË JANË ZYRAT E SHËRBIMIT?

- Zyrat e Shërbimit janë struktura të cilat ngrihen dhe funksionojnë pranë godinave të ish Gjykatave të Apeleve Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë dhe Shkodër me qëllim ofrimin e shërbimeve administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor.
- Zyrat e Shërbimit janë pjesë e Sektorit të Protokollit, Arkivës dhe të Koordinimit të Zyrave të Shërbimit, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Kancelari i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe funksionimin e zyrave të shërbimeve dhe siguron koordinimin me shërbimet e tjera të gjykatës.

CILAT JANË FUNKSIONET E ZYRAVE TË SHËRBIMIT NË PERIUdhËN KALIMTARE?

Nëpunësit e Zyrave të Shërbimit, kryejnë të gjitha detyrat e sekretarit gjyqësor si dhe veprimet që lidhen me administrimin e dosjeve gjyqësore të çështjeve të përfunduara deri në datën 31 Janar 2023, të tilla si:

- komunikimin e vendimeve gjyqësore palëve ndërgjyqëse;
- komunikimin e rekursit/kundër-rekursit palëve ndërgjyqëse në çështjet civile dhe përcjelljen e dosjes gjyqësore me aktet e plota për vlerësim nga gjyqtari relator në lidhje me lejimin e rekursit;
- komunikimin e rekursit palëve ndërgjyqëse në çështjet penale dhe përcjelljen e dosjes gjyqësore me aktet e plota për në Gjykatën e Lartë;
- përcjelljen për në gjykatat e rretheve gjyqësore përkatëse, të dosjeve gjyqësore për çështjet e përfunduara për të cilat nuk është ushtruar rekurs;
- kryerjen e veprimeve lidhur me arkivimin e dosjeve të çështjeve të juridiksionit fillestar, për të cilat nuk është ushtruar rekurs;
- kryerjen e detyrave të tjera sipas nevojës dhe delegimit nga Kancelari i Gjykatës.

KËRKESAT QË MUND TË PARAQITEN NËPËRMJET ZYRAVE TË SHËRBIMEVE NË RRETHE

- Kërkesë/Kërkesëpadi që gjykohen si shkallë e parë në Gjykatën e Apelit Juridiksionit të Përgjithshëm;
- Kërkesat për plotësim, sqarim, interpretim vendimi dhe ndreqje gabimi;
- Kërkesë për kopje vendimi/akteve nga Zyra e Arkivës;
- Kërkesë për kopje të akteve për çështje gjyqësore në proces;
- Rekursat/kundërrekursat;
- Kërkesë për vërtetim mbi çështjet e gjykuara apo në gjykim;
- Kërkesë për informacion mbi çështjet e regjistruar në gjykatë;
- Kërkesë për përshpejtim të çështjeve gjyqësore të regjistruara;
- Kërkesat për depozitimin e të dhënave të kontaktit të palëve apo përfaqësuesve të tyre për çështjet gjyqësore në proces si dhe çdo të dhënë për ndryshimin e adresave të vendbanimit;
- Depozitim të aktit të përfaqësimit të çështjeve gjyqësore të regjistruara;
- Kërkesa për përjashtim të trupi gjykues në çështjet civile;
- Kërkesat për heqje dorë nga ankimi;
- Kërkesat për informacion të publikut dhe medias;
- Kërkesat për çështjet gjyqësore në proces.

KËRKESAT QË DUHET TË PARAQITEN VETËM NË GJYKATËN E APELIT JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

- Kërkesë përjashtim të gjyqtarit në çështje penale;
- Shuarje mase sigurimi në procesin penal;

Adresa e Gjykatës:

Bulevardi "Zhan D'Ark"
(Godina aktuale e Gjykatës së Apelit Tiranë)

Kontakte:

- ✉ sherbime@gjykata.gov.al
- ☎ +355 67 73 74 414
- ☎ +355 67 73 74 414



ZYRA E SHËRBIMIT GJYQËSOR

JU VJEN NË NDIHMË PËR:

- Shërbim Protokolli
- Shërbim Arkive
- Depozitim Aktesh
- Kërkesa për çështje gjyqësore në proces
- Tërheqje vendimi
- Depozitim Rekursesh / Kundër-Rekurseve
- Kopje të Rekurseve / Kundër-Rekurseve
- Marrje informacioni
- Vërtetime
- Kërkesë për informim
- Publikim i shortit elektronik
- Publikim i listave të gjykimit

Njoftojmë se godinat e ish-Gjykatave të Apelit do të funksionojnë si Zyra Shërbimi për ti ardhur në ndihmë publikut dhe palëve në proces me të gjitha shërbimet e listuara më sipër.

PËR PUBLIKUN

067 73 74 414

sherbime@gjykata.gov.al



PER MEDIAN

068 57 13 708

info@gjykata.gov.al